



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1306/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Etor Hoxha, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Gjakovë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, Anr. 1107/2013, të datës 03.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Hidhet** si i pasafatshëm apeli i Etor Hoxha, Kandidat për Anëtar të Kuvendit Komunal në Gjakovë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër vendimit të PZAP-it, Anr. 1107/2013, të datës 03.12.2013.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 19.12.2013, nga Etor Hoxha, kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Gjakovë nga subjekti politik AKR, për rishikim të vendimit Anr.1107/2013, të datës 03.12.2013, në të cilin thekson se me datë 3 Dhjetor 2013, ka bërë ankesë ku ka pretenduar se është bërë keq numërimi i rezultateve respektivisht reflektim i gabuar i rezultateve në QV0204C/03R, ku në bazë të rezultateve preliminare pretendon se i ka pasur 6 vota, kurse në rezultatin final të QNR-së, janë 0 vota. Në QV0201C/03R në bazë të rezultateve preliminare të dërguara nga KKZ, kandidati i AKR-së me nr. 15 i ka pasur 2 vota, kurse në rezultatet finale të njëjtit i janë regjistruar 12 vota. Më tutje parashtuesi i apelit thekson se, nga kopja e FRK-së e siguruar në Gjakovë, vërehet se është bërë ndërhyrje dhe rezultati është manipuluar nga 002 në 12. Po ashtu parashtuesi i apelit thekson se nga të gjitha FRK-të, vetëm ky nuk është origjinali, por vetëm fotokopja e bardhë, gjë që sikur të ishte origjinal do të vërehej edhe më shumë manipulimi i cili mendon se është bërë vetëm në këtë FRK, kurse votat në kuti të votimit, i konsideron se janë të vërteta ashtu siç kanë qenë para ndryshimit të rezultateve.

Parashtuesi i ankesës në cilësi të provës i ka bashkangjitur kopjen e FRK-së nga QV si dhe rezultatin final të Etor Hoxha.

PZAP-i në kuptim të nenit 1.8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ankesën në fjalë e ka rikualifikuar si apel ndaj Vendimit Anr.1107/2013 të datës 03.12.2013, ngase e ka konsideruar se do të trajtohet në mënyrë më të duhur si apelim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e apelit gjeti se:

**apeli është i pa afatshëm**

PZAP-i, konstaton se apeli është i pasafatshëm sepse afati për të parashtruar apel ndaj vendimit të PZAP-it sipas nenit 118.4 të LZP-së, është 24 orë nga momenti i marrjes së vendimit të PZAP-it.

Në rastin konkret, kandidatit për anëtarë të kuvendit komunal Etor Hoxha në Gjakovë, për shkak të ekonomizimit të çështjes PZAP-i, ja ka dërguar vendimin Anr.1107/2013 nëpërmes email-it zyrtar të PZAP-it të cilin email personi në fjalë e ka konfirmuar me datë 10.12.2013 se ka pranuar email-in.

Ndërsa apelin ndaj vendimit të ankimuar është parashtruar në PZAP me datë 19.12.2013, në ora 15:20, me çka nënkupton se kanë kaluar të gjitha afatet e parapara ligjore për të ankimuar vendimin në fjalë, ngase neni 118 paragrafi 4, parasheh se afati për të parashtruar apel ndaj një vendimi të PZAP-it është 24 orë nga momenti i marrjes së vendimit prandaj PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1306/2013 më datën 23.12.2013.



**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.